



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 25.4.2023

Nr: 411

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMEVE NR. 220 ID, 221 ID, 282 ID, 320, TË KOALICIONIT PËR REFORMA, INTEGRIM DHE INSTITUCIONE TË KONSOLIDUARA, PËR SHKELJE PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Sot, më datë 25 Prill 2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim çështjen administrative me:

KËRKUES: Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)

SUBJEKT: Z. Nuri belba, kryetari i bashkisë Prrenjas
Zj. Urjeta Kurti, person përgjegjës për raportim, bashkia Dibër
Z. Bajram Pishkashi, person përgjegjës për raportim, bashkia Librazhd
Zj. Erisa Qalliu, person përgjegjës për raportim, bashkia Lushnje

OBJEKT: Shqyrtim administrativ ndaj personave përgjegjës për shkelje administrative

BAZA LIGJORE: Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, neneve 91, 92 dhe nenit 171 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

K O N S T A T O J :

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka marrë denoncime për organizimin e 4 (katër) veprimtarive publike, nga 4 (katër) institucione publike, për të cilat pretendohet se janë shkelur parashikimet e nenit 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor.

Data: 25.04.2023

Nr: 411
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve”

Denoncimet dhe indiciet janë marrë nëpërmjet provave link, të administruara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, pasi shqyrtova paraprakisht çështjen, vlerësoj se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ.

Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcaktojnë kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve janë paraqitur disa denoncime, që i drejtohen subjekteve të ndryshme dhe meqenëse objekti i shqyrtimit bazohet në të njëjtat fakte dhe bazë ligjore, në mbështetje të nenit 65, shkronja “ç” të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, u vendos shqyrtimi së bashku i këtyre denoncimeve.

Në vijim të procedurës administrative, fillova hetimin administrativ, duke kërkuar informacion në lidhje me veprimtaritë publike për të cilat ka indicie të besueshme se ka shkelje të dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator.

Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ka kërkuar nga institucionet publike nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail, informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljeve, si dhe të drejtën e tyre për t’u paraqitur në seancë publike.

Denoncuesi pretendon si më poshtë vijon:

1- Bashkia Librazhd ka zhvilluar 1 (një) veprimtari publike, të regjistruar me **nr. 221 ID**, për të cilën pretendohet si vijon:

- **Denoncimi nr. 221 ID**, i iniciuar nga Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK) ku pretendohet se: *“Në datën 18 mars 2023 Bashkia Librazhd ka postuar në faqen e saj zyrtare në Facebook: “Zemra mal” Ndërkohë që ripostohet postimi i bërë nga Drejtuesi Politik i Qarkut Elbasan z. Damian Gjijnuri, i cili ka përmbajtjen e mëposhtme:*

“Librazhd-Njësia Administrative Polis. Librazhd Njësia Administrative Polis. Nxënësit e shkollës në Mirakë-Plane marrin mësim në kushte optimale falë godinës së re e cila është ndërtuar sipas të gjitha standardeve.

#TëBashkuarJoTëNdarë

#ShqipëriaEArdhmjaJonë

#SkaKohëPërPushim”

Postimi video lidhur me këtë aktivitet i bërë nga Drejtuesi Politik i Qarkut Elbasan z. Damian Gjijnuri është parë 19 000 herë, i janë bërë 525 komente dhe ka marrë 3700 pëlqime (deri në momentin e dërgimit të këtij Raporti Javor).

Zhvillimi i këtij takimi është raportuar në ndërfaqen e KQZ nga Bashkia Librazhd. Në njoftimin e bërë lidhur me këtë veprimtari thuhet:

“Inspektim i punimeve në Shkollën 9-vjecare Mirakë-Plane

Lloji i Aktivitetit: Inspektim/kontroll

Data: 16/03/2023

Ora: 11:00

Vendi i Zhvillimit: Fshati Mirake-Plane, Njësia Administrative Polis

Shteti: Shqipëri

Qarku: Elbasan

Bashkia: Librazhd

Njësia Administrative: Polis

Folësit kryesorë: Damian Gjijnuri | Kastriot Gurra

Pozicioni: Deputet | Kryetar Bashkie

Pjesëmarrësit: Përfaqësues të Bashkisë Librazhd, Përfaqësues të firmes, banorë të fshatit

Me pjesëmarrjen e medias: Jo

I hapur për publikun: Po

Përpos prezencës së përfaqësuesit politik në këtë veprimtari, vërehen disa shkelje si:

a. Informacion i pavërtetë në raportim:

- ndërsa njoftohet për inspektim punimesh, në fakt nga postimi video rezulton se është një aktivitet **promovimi i investimit të përfunduar tashmë, madje në efikasitet të plotë.**

- ndërsa njoftohet se pjesëmarrësit do të jenë “Përfaqësues të bashkisë Librazhd, përfaqësues të firmes, banorë të fshatit”, në fakt nga postimi video rezulton se aty **ka staf mësimor dhe nxënës të shkollës, e tërë kjo në një ditë të zakonshme mësimi.**

b. Ndahet në Faqen Zyrtare të Bashkisë Librazhd, “Bashkia Librazhd - Faqja Zyrtare” ku edhe citohet “Kryetari i Bashkisë Librazhd”, një postim i Drejtuesit Politik të Partisë Socialiste për Qarkun Elbasan.

c. Publikohen në Faqen Zyrtare të Bashkisë Librazhd, “Bashkia Librazhd - Faqja Zyrtare” ku edhe citohet “Kryetari i Bashkisë Librazhd”, sloganet elektorale të Partisë Socialiste për Zgjedhjet Parlamentare 2021.

d. Organizohet një aktivitet promovimi në ambientet e Shkollës 9-vjecare Mirake-Plane gjatë një dite të zakonshme mësimi, ku marrin pjesë stafi mësimor dhe nxënësit e shkollës.

Pavarësisht se postimi i bërë mban datën 18.03.2023, që është ditë e shtunë, nga pamjet e videos duket qartë se bëhet fjalë për një ditë mësimi, ku stafi mësimor është me përparëse, ndërsa fëmijët dhe klasat me çantat e shkollës. Më shumë gjasë, dita e realizimit të aktivitetit është data 16 mars, e deklaruar nga bashkia.”

Më datë 28.3.2023, bashkisë Librazhd i është kërkuar informacion në lidhje me indiciet e marra, nëpërmjet adresës elektronike, dhe më datë 28.3.2023 ka sqaruar se “*Nisur nga e-mail juaj për aktivitetin e datës **datës 18 mars 2023**, nga ana jonë ju sqarojmë se ka qënë e planifikuar inspektim punimesh dhe jo inagurim. Nëse ju jeni të vëmendshëm në video nuk ka as foni as mikrofon as shirit inagurimi dhe mbi të gjitha nuk kishte pregatitje inagurimi nga ana jonë pasi shkolla ishte akoma në proces sistemimi. Besoj këta element janë bazat fillesare të një inagurimi. Klasat e tjera janë të pa sistemuara me banka, tualetet e papërfunduara dhe nxënësit e vazhdonin mësimin akoma në ambientet e shkollës tjetër ku kishin kaluar për këtë vit akademik. E ritheksojmë nxënësit e shkollës nuk vazhdonin mësimin në atë godinë. Kjo ishte e pregatitur nga ana e prindërve nga dëshira e mirë dhe në shenjë falenderimi për këtë ambient komod për fëmijët e tyre. Pra e gjitha ishte një surprizë për NE. Bashkia Librazhd është aktualisht duke planifikuar inagurimin e këtij objekti dhe duke pregatitur një aktivitet falenderues për Fondacionin Mirësia dhe Z. Korab Kaja për këtë dhuratë që na ka bërë. Në asnjë moment Kryetari Bashkisë nuk ka përdorur fjalë elektorale në fjalimin e tij.”*

Më datë 7.4.2023, i është kërkuar bashkisë Librazhd informacion si më poshtë vijon “*Kërkojmë nga ana juaj, rivleresim të videos të postuar në rrjetin social të bashkisë Librazhd, pasi nga video konstatohet, që shkolla është e përfunduar si dhe ka mësuesit që janë me uniforma të veshura. Për shkak dhe të fjalës së mbajtur nga z. Damian Gjikhuri, ka dyshime nëse është inspektim apo inagurim”, por bashkia Librazhd nuk i është përgjigjur kërkesës sonë.*

Në vijim të procedurës administrative, bashkia Librazhd është njoftuar për zhvillimin e seancës publike të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, të datës 25.4.2023, ora 12:00. Në seancë nuk u paraqit asnjë përfaqësues i bashkisë.

Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerësoi se: Referuar nenit 4, pika 3 e vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator “*Struktura përkatëse e teknologjisë së informacionit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve mundëson akses të personalizuar në këtë ndërfaqe për të gjitha subjektet e përcaktuara në pikën 2, të nenit 3, të këtij vendimi, me qëllim që të hedhin të dhënat për **institucionin që organizon veprimtarinë, datën dhe orën e veprimtarisë, tematikën e veprimtarisë, nivelin më të lartë të pjesëmarrjes, të ftuarit e nderit, folësit e planifikuar dhe mediatizimin e veprimtarisë**”, institucioni organizator ka detyrimin që të raportojë në ndërfaqe të gjitha aktivitetet që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut, apo të medias si dhe ato që kanë në agjendë informimin e publikut, duke plotësuar ccdo rubrikë që përcaktohet në këtë nen.*

Të dhënat e marra nga ky nen, ndihmojnë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve në vlerësimin e një veprimtarie si “të lejuar” apo “të ndaluar” për t’u zhvilluar, si dhe monitorimin e saj, në rastet kur e konsideron të arsyeshme. Mosplotësimi i këtyre të dhënave, në formën e kërkuar nga vendimi nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, do të ccontë në një vlerësim jo të drejtë si dhe në pamundësinë për të monitoruar këtë aktivitet. Bashkia Librazhd, ka raportuar se aktiviteti “Inspektim i punimeve në Shkollën 9-vjecare Mirakë-Plane” do të zhvillohej më datë 16.3.2023, ndërkohë, referuar e-mail të datës 28.3.2023, vetë bashkia pranon se aktiviteti është zhvilluar më datë 18.3.2023. Gjithashtu, vërehet se nuk ka deklarime të plota për pjesëmarrjen në këtë aktivitet.

Për aq sa është deklaruar në raportimin e aktivitetit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve e ka vlerësuar aktivitetin si të lejuar për t’u zhvilluar. Megjithatë, raportimi i pjesshëm dhe jo i plotë nga ana e bashkisë Librazhd ka cënuar mundësinë për vlerësimin e këtij aktiviteti në mënyrë të duhur.

Referuar pjesëmarrjes së deputetit z. Gjijnuri, vlerësojmë se pjesëmarrja e deputetit jo domosdoshmërisht e kategorizon veprimtarinë si të ndaluar për t’u zhvilluar. Pjesëmarrja e deputetit jo domosdoshmërisht e kthen aktivitetin e një institucioni publik, në një aktivitet elektoral. Fjalimi me përmbajte elektorale, logot, materialet propagandistike dhe çdo element tjetër, që mbart mesazhe elektorale, janë elementë që e kthejnë aktivitetin në të tillë. Nuk u arrit të provohej, se në takim ka pasur thirrje elektorale.

Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezulton se objekti rast hetimi pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ndaj bashkisë Librazhd përbën shkelje të nenit 92, pika 3 e Kodit Zgjedhor dhe e nenit 4, pika 3 e vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator. Referuar pikës 1, të nenit 10 të vendimit nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit rregullator “Në rastet kur subjektet e parashikuara në pikën 4, të nenit 4, të këtij vendimi, nuk raportojnë, **raportojnë pjesërisht** ose zhvillojnë veprimtarinë, pavarësisht ndalimit të bërë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, kur shkelja nuk përbën vepër penale, dënohen nga Komisionieri Shtetëtor i Zgjedhjeve me gjobë nga 3000 (tremijë) deri në 90 000 (nëntëdhjetë mijë) lekë, sipas nenit 171, pika 1, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

2- Bashkia Prrrenjas ka zhvilluar 1 (një) veprimtari publike, të regjistruar me **nr. 282 ID**, për të cilën pretendohet si vijon:

- **Denoncimi nr. 282 ID**, i iniciuar nga Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK) ku pretendohet se: *“Më datë 05.04.2023, bashkia Prrrenjas ka zhvilluar një veprimtari publike të cilën e ka njoftuar paraprakisht në ndërfaqen e KQZ-së, në datën*

31.03.2023. Në këtë aktivitet ka marrë pjesë edhe Drejtuesi Politik i Qarkut Elbasan, deputet i Qarkut Vlorë dhe Sekretar i Përgjithshëm i Partisë Socialiste z. Damian Gjikhuri. Njoftimi për zhvillimin e kësaj veprimtarie publike është postuar në faqen zyrtare të bashkisë Prrenjas postim i shpërndarë nga faqja zyrtare e kryetarit të Bashkisë Prrenjas Z. Nuri Belba.

“ME NJERËZIT PËR NJERËZIT

Rashtan Bashkëbiseduam me banorët mbi ato çfarë kemi bërë dhe do të bëjmë për t'u dhënë zgjidhje ditë pas dite problematikave të tyre.

#TëBashkuarJoTëNdarë

#ShqipëriaEArdhmjaJonë

#SkaKohëPërPushim”

Gjithashtu foto të këtij aktiviteti janë postuar edhe në faqen zyrtare të z. Gjikhuri, me këtë përmbajtje: “Me Njerëzit për Njerëzit-Rehabilitimi i plotë i rrugës në fshatin Rashtan është një tjetër shembull i punëve të mira që Kryetari Nuri Belba po kryen në Prrenjas. Gjatë bashkëbisedimit me banorët e kësaj zone mësova se rruga kishte qenë një kërkesë e kahershme e tyre. I garantova se me Nuren në krye të punëve edhe për katër vite të tjera si edhe mbështetjen e pakursyer të qeverisë do vijojmë t'u qëndrojmë pranë për të zgjidhur problematikat e tyre.

#TëBashkuarJoTëNdarë

#ShqipëriaeArdhmjaJonë

#SkaKohëPërPushim”

Ndërsa video e postuar mbi këtë aktivitet, sërish në faqen në Facebook-ut të z. Gjikhuri ka këtë përmbajtje:

“Me Njerëzit për Njerëzit

Prrenjas Me banorët e fshatit Rashtan mbi çfarë kemi bërë dhe do të bëjmë për t'u dhënë zgjidhje ditë pas dite problematikave të tyre.” Ky aktivitet “Inspektim i punimeve” i organizuar nga Bashkia Elbasan është përdorur haptas dhe qartas për të kryer diskutime elektorale dhe kryer premtime të drejtpërdrejta në emër të maxhorancës në funksion të zgjedhjeve të 14 majit. Jo vetëm kaq, por komentet e kryera nga z. Gjikhuri i lidhin drejtpërdrejt investimet pas zgjedhjeve për bashkinë me zgjedhjen sërish të Kryebashkiakut aktual.

Drejtuesi politik i PS për Qarkun Elbasan z. Damian Gjikhuri: “(...) E tha vetë Nurja dhe një nga arsytet pse ne e kemi mbështetur atë është realisht, që roli i bashkisë është të mirë administrojë fondet lokale, qeveria qendrore do e mbështesë me projektet më të mëdha kryesore. Dhe në këtë binom duam ta lidhim shumë mirë, pra punën e mirë të bashkisë, projektet e kryetarit, mbështetjen nga qeveria qendrore me projekte të tjera. Kështu që, thashë puna flet vetë, kjo është një punë e filluar dhe jam i bindur që ky është modeli jonë i vazhdueshëm edhe për katër

vitet e tjera. Punë, punë, punë, ndryshime në infrastrukturë, investime serioze për të ndryshuar jetën e fshatit, pastaj fshati është i zoti i vetes i del për zot punëve të tij. Alternativat e tjera politike janë alternativa që nuk i interesojnë Prrenjasit, janë alternativa që e çojnë mbrapa, dhe kjo zonë do patjetër binomin Prrenjas bashki e mirë administruar nga Partia Socialiste mbështetje e qeverisë qendrore dhe këto janë veprat që po i shikojnë gjithë qytetarët sot.”

Fjalimi i plotë në këtë link:

<https://www.facebook.com/Gjikhuri.Damian/videos/948439219495015/>

Vlen të theksohet se nga konsultimi i raportimit të bashkisë Prrenjas në ndërfaqe për këtë aktivitet, rezulton se aktiviteti është publik, i hapur për pjesëmarrjen e medias dhe publikun, si dhe paralajmërohet pjesëmarrja në të, e z. Damian Gjikhuri, udhëheqës politik i Qarkut Elbasan.”

Më datë 11.4.2023, bashkisë Prrenjas i është kërkuar informacion në lidhje me indicien e marrë, nëpërmjet adresës elektronike por nuk i janë përgjigjur kërkesës sonë.

Në vijim të procedurës administrative, bashkia Prrenjas është njoftuar për zhvillimin e seancës publike të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, të datës 25.4.2023, ora 12:00. Në seancë nuk u paraqit asnjë përfaqësues i bashkisë.

Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerësoi se:

Referuar nenit 91, pika 1 e Kodit Zgjedhor “**Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia**”

Referuar të dhënave të deklaruara në ndërfaqen e raportimeve, aktiviteti i bashkisë Prrenjas është konsideruar i lejuar për t’u zhvilluar, në kuptim të nenit 3, të vendimit, nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator. Pjesëmarrja e deputetit të zonës apo e funksionarëve politike jo domosdoshmërisht e kthen aktivitetin e një institucioni publik, në një aktivitet elektoral. Fjalimi me përmbajtje elektorale, logot, materialet propagandistike dhe çdo element tjetër, që mbart mesazhe elektorale, janë elementë që e kthejnë aktivitetin në të tillë. Të ndodhur në kushtet që jemi në periudhë zgjedhore, të gjithë aktorët politikë dhe drejtuesit e organeve publike duhet të tregojnë kujdes të shtuar në përdorimin e fjalimeve me përmbajtje elektorale, në takimet e organizuara në përmbushje të funksioneve të tyre.

Gjatë fjalës së z. Gjicknuri, janë vërejtur përdorimi i thirrjeve elektorale në takim. Përdorimi i aktivitetit të organizuar nga një organ publik, për të kryer thirrje elektorale, përbën përdorim burimesh publike në kuptim të nenit 91 të Kodit Zgjedhor. Përsa më sipër, kryetari i bashkisë Prrenjas, me lejin për përdorim të një aktiviteti publik, për kryerjen e thirrjeve elektorale, ka përdorur burime publike të organit që ai drejton, duke shkelur kështu detyrimet që përcakton neni 91 i Kodit Zgjedhor. Referuar nenit 171, pika 1, të Kodit Zgjedhor, kur shkelja nuk përbën veprë penale, dënohet me gjobë nga 3000 (tremijë) deri në 90 000 (nëntëdhjetë mijë) lekë.

3- Bashkia Dibër ka zhvilluar 1 (një) veprimtari publike, të regjistruar me **nr. 320 ID**, për të cilën pretendohet si vijon:

- **Denoncimi nr. 320 ID**, i iniciuar nga Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK) ku pretendohet se: *“Bashkia Dibër ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve të KQZ në datën 9 prill 2023 se programon të zhvillojë më datën 15 prill aktivitetin me temë “Inspektim në njësinë Slllovë”. Nga konsultimi i faqes në Facebook të Kryetarit të Bashkisë Dibër, vërehet se aktiviteti me këtë temë është postuar në datën 13 Prill 2023.*

Postimi ka këtë përmbajtje:

“Në #Sllovë, gjatë inspektimit të punës për rehabilitimin e rrugës lidhëse të fshatrave Venisht-Sllatinë!

#VetëmPërpara

#KurrëMëMbrapa.”

Nga kontrolli që u bë në kanalet zyrtare të informimit të titullarit dhe institucionit përkatës, nuk evidentohet asnjë postim tjetër online për zhvillimin e këtij aktiviteti. Pra, rezulton se aktiviteti është kryer dhe data e deklaruar për zhvillimin e tij, në ndërfaqen e raportimit të KQZ-së, ka qenë e plotësuar gabim”.

Më datë 17.4.2023, bashkisë Dibër i është kërkuar informacion në lidhje me indicien e marrë, nëpërmjet adresës elektronike dhe më datë 19.4.2023, jemi informuar se *“Bashkia Dibër ka raportuar në ndërfaqen e KQZ në datën 9 Prill 2023, se aktiviteti “Inspektim në Njësinë Slllovë” do të zhvillohej në datën 15 Prill. Nga ana jonë është bërë një gabim material dhe aktiviteti do të zhvillohej në datën 13 Prill 2023 sicc është postuar në faqen e facebook të kryetarit”.*

Në vijim të procedurës administrative, bashkia Dibër është njoftuar për zhvillimin e seancës publike të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, të datës 25.4.2023, ora 12:00. Në seance nuk u paraqit asnjë përfaqësues i bashkisë.

4- Bashkia Lushnje, ka raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 1 (një) veprimtari publike, të regjistruara me **nr. 220 ID**, për të cilën pretendohet si vijon:

Data: 25.04.2023

Nr: 411
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve”

- Denoncimi nr. 220 ID “Në datën 23 mars 2023 kryetarja e bashkisë Lushnje ka postuar në faqen e vet në Facebook dy postime për të njëjtin aktivitet, një me video dhe një me foto:

“#LushnjëPuna në kantierin e rrugës së #Bitaj, po ecën shumë mirë!

Segmenti me gjatësi 3.7 km që e lidh këtë zone me aksin kombëtar do ti japë një frymëmarrje të madhe ekonomisë bujqësore! #BashkiaNëPunë”

Një postim lidhur me këtë aktivitet ka bërë edhe Drejtuesi Politik i Qarkut Fier z. Taulant Balla: “#Punëjollafe

LushnjëPunohet me ritme të shpejta në kantierin e rrugës së #Bitaj, segment shumë i rëndësishëm 3.7 km që lidh ekonominë bujqësore të kësaj zone me aksin kombëtar Premtim i mbajtur

#TëBashkuarJoTëNdarë

#ShqipëriaEArdhmjaJonë

#SkaKohëPërPushim”

Zhvillimi i këtij takimi është raportuar në ndërfaqen e KQZ nga Bashkia Lushnjë. Në njoftimin e bërë deklarohet paraprakisht nga Bashkia se pjesëmarrësit do të ishin:

“Taulant Balla, Eriselda Sefa”.

Më datë 28.3.2023 bashkisë Lushnje i është kërkuar informacion në lidhje me indicien e marrë, nëpërmjet adresës elektronike dhe më datë 30.3.2023 ka bërë me dije se “Në datën 23 mars 2023 kryetarja e bashkisë Lushnje ka postuar në faqen e vet në Facebook postime për aktivitetin Inspektim punimesh ne Bitaj ky inspekim është raportuar nga ana e institucionit tonë për në datën 23/03/2023 link <https://aktivitete.kqz.gov.al/2023/03/18/inspektim-punimesh-ne-rrugen-e-bitajkolonje/> sipas afateve ligjore. Për arsye të ftesës nga Dhoma Ekonomike e Gruas, e cila ka ftuar kryetaren në panelin kryesor të takimit, aktiviteti i raportuar më sipër u zhvillua në datën 22/03/2023.

Theksojme se aktiviteti është inspektim punimesh, pune të perditshme të titullares, jo aktivitet me pjesëmarrje të gjerë publiku. Institucioni ynë për të respektuar këtë raportim nuk e ka publikuar këtë inspektim në faqen zyrtare të bashkisë Lushnje, kurse kryetarja e ka postuar në faqen e saj personale në datën 23.03.2023, në përputhje me datën e raportimit. Ju lutem na mirëkuptoni që smund të jemi ne pergjegjës cfarë publikohet në faqen në facebook të drejtuesit politik T. Balla Bashkangjitur ftesa nga Dhoma Ekonomike e Gruas, aktivitet i dates 23.03.2023.”

Në vijim të procedurës administrative, bashkia Dibër është njoftuar për zhvillimin e seancës publike të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, të datës 13.4.2023, ora 12:00.

Në seance nuk u paraqit asnjë përfaqësues i bashkisë.

Në përfundim të hetimit administrative për denoncimet me nr. 320 ID, për bashkinë Dibër dhe 220 ID, për bashkinë Lushnje Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerësoi se:

Data: 25.04.2023

Nr: 411
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve”

Referuar nenit 4, pika 3 e vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator “Struktura përkatëse e teknologjisë së informacionit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve mundëson akses të personalizuar në këtë ndërfaqe për të gjitha subjektet e përcaktuara në pikën 2, të nenit 3, të këtij vendimi, me qëllim që të hedhin të dhënat për **institucionin që organizon veprimtarinë, datën dhe orën e veprimtarisë, tematikën e veprimtarisë, nivelin më të lartë të pjesëmarrjes, të ftuarit e nderit, folësit e planifikuar dhe mediatizimin e veprimtarisë**”, institucioni organizator ka detyrimin që të raportojë në **ndërfaqe, 5 (pesë) ditë** para të gjitha aktivitetet që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut, apo të medias si dhe ato që kanë në agjendë informimin e publikut, duke plotësuar ccdo rubrikë që përcaktohet në këtë nen.

Të dhënat e marra nga ky nen, ndihmojnë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve në vlerësimin e një veprimtarie si “të lejuar” apo “të ndaluar” për t’u zhvilluar, si dhe monitorimin e saj, në rastet kur e konsideron të arsyeshme. Mosplotësimi i këtyre të dhënave, në formën e kërkuar nga vendimi nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, do të cconte në një vlerësim jo të drejtë si dhe në pamundësinë për të monitoruar këtë aktivitet.

Institucionet, të cilat vërejnë se kanë bërë gabime materiale në raportimin e aktivitetit apo kanë ndryshim agjende dhe nuk mund ta kryejnë aktivitetin, sipas të dhënave të raportuara, në ccdo kohë duhet të venë në dijeni Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Është Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, i cili vlerëson nëse aktiviteti i raportuar, mund të zhvillohet apo jo.

Referuar denoncimit nr. 320 ID, bashkia Dibër ka raportuar më datë 9.4.2023 se aktiviteti “Inspektim në njësinë Sllovë” do të zhvillohej më datë 15.4.2023, ndërkohë, referuar e-mail të datës 17.4.2023, vetë bashkia pranon se aktiviteti është zhvilluar më datë 13.4.2023. Vlerësohet se, nëse do të merrej parasysh gabimi material i kryer nga ana e personit përgjegjës për raportim, për bashkiinë Dibër, atëherë ai do të ishte në shkelje të afatit 5 (pesë) ditor, të përcaktuar nga neni 92 e Kodit Zgjedhor.

Referuar denoncimit nr. 220 ID, bashkia Lushnje, ka pasur mundësinë të njoftojë ndryshimin e agjendës të kryetarit të bashkisë dhe megjithatë, personi përgjegjës nuk ka bërë raportimin e nevojshëm pranë ndërfaqes së raportimeve.

Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezulton se objekti rast hetimi pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ndaj bashkisë Dibër dhe bashkisë Lushnje, përbën shkelje të nenit 92, pika 3 e Kodit Zgjedhor dhe e nenit 4, pika 3 e vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator.

Referuar pikës 1, të nenit 10 të vendimit nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit rregullator “Në rastet kur subjektet e parashikuara në pikën 4, të nenit 4, të këtij vendimi, nuk raportojnë,

raportojnë pjesërisht ose zhvillojnë veprimtarinë, pavarësisht ndalimit të bërë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, kur shkelja nuk përbën vepër penale, dënohen nga Komisioneri Shtetëtor i Zgjedhjeve me gjobë nga 3 000 (tremijë) deri në 90 000 (nëntëdhjetë mijë) lekë, sipas nenit 171, pika 1, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pika 1, shkronja “n” dhe 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimet nr. 9, datë 9.3.2021 dhe nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator

V E N D O S:

1. T’i propozojë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative me gjobë ndaj z. Nuri Belba, kryetar i Bashkisë Prrenjas, në vlerën 10 000 (dhjetë mijë) lekë.
2. T’i propozojë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative për:
 - Zj. Urjeta Kurti, person përgjegjës për raportim, në Bashkinë Dibër, gjobë në masën 5 000 (pesë mijë) lekë;
 - Z. Bajram Pishkashi, person përgjegjës për raportim, në Bashkinë Librazhd, gjobë në masën 5 000 (pesë mijë) lekë;
 - Zj. Erisa Qalliu, person përgjegjës për raportim, në Bashkinë Lushnje, gjobë në masën 5 000 (pesë mijë) lekë
3. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet postës elektronike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Kopje: 4
Afati i ruajtjes: 5 vjet
Punoi:
I.Horanlliu _____
M.Koja _____
A. Lamçe _____
Y.Merkaj _____

Data: 25.04.2023

Nr: 411
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve”